



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:104346

Datë: 16.02.2021

Numri i dokumentit: 01512636

C.nr.543/2017

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtarën Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Korporata Energjetike të Kosovës Sh.a (KEK) Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) “Bulevardi Bill Kllinton” Nr.3, Ndërtesa Elektrokosovës kati i II nr.5, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J.M – jurist i diplomuar nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurit A. A nga Gjilani, të cilin me autorizim e përfaqëson Freskim Musliu avokat nga Gjilani, i caktuar nga Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas në Gjilan, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë te kontestit prej 149,64.00€ , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, jashtë seance gjyqësore më datën 23.12.2020 ndërsa me datën 25 Janar 2021 e përpiloi me shkrim këtë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Korporata Energjetike të Kosovës (KEK) e paraqitur ndaj të paditurit A. A nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që i padituri të obligohet t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 149,64€, edhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjeri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II. OBLIGOHET** paditësja që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100,00€, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja në këtë gjykatë me dt.02.08.2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material në vlerë prej 149,64€ dhe i njejt ka theksuar se prej datës së pavërtetuar e deri me dt.02.02.2012, në shtëpinë e tij me qëllim që ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke keqpërdorur njehsorin elektrik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ku në këtë mënyrë ka pamundësuar regjistrimin e

energjisë elektrike të shpenzuar, andaj nga këto veprime e ka dëmtuar paditësin në vlerën e lartëcekur, dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë t'a aprovojë në tërësi si të bazuar duke detyruar të paditurin që të kompensojë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 149,64 € bashkë me shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimrore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi më datën 29.08.2017, të cilin i padituri e ka pranuar më datën 11.09.2017 ( e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësin që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuse, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar seancën për datën 23.12.2020, ku kanë prezentuar të dy palët ndërgjyqëse ku i autorizuari i paditëses si në seancën përgatitore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë lidhur me dëmin e shkaktuar nga pala paditëse pasi që e njëjta është vërtetuar edhe me aktgjykimin penal P.nr.565/12 ku është konstatuar se energjia elektrike është shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme. Po ashtu i njëjti i ka kundërshtuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës i cili është thirrur në parashkrim andaj një gjë e tillë nuk ekziston për faktin se me LMD-ën parashihet se kur kemi të bëjmë me aktgjykim penal është edhe zgjatja e afatit më parashkrimit 3+3, ndërsa sa i përket provave konsiderojme se transaksioni i konsumatorit e pasqyron gjendjen reale dhe faktike të konsumatorit. Andaj mbi këtë bazë i njëjti kërkon nga gjykata që të aprovet kërkesëpadia e tyre dhe të obligohet i padituri t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 149,64€, edhe atë me kamatë ligjore, duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

I autorizuari i të paditurit av.Freskim Musliu si në seancën përgatitore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar në ligj, por edhe të pa mbështetur në prova. Ka shtuar se është e vërtetë se i padituri është denuar nga kjo gjykatë për veprën penale vjedhje sipas aktgjykimin penal P.nr.565/12 të dt.10.09.2012 mirëpo padinë e ka paraqitur pas katër viteve që do të thotë se një kërkesë e tillë është parashkruar, ngase për këtë vepër penale sipas nenit 252 të Kodit të Përkohshëm Penal ka qenë e denueshme me maksimum deri në 3 vite, ndërsa sipas nenit 90 par.1 nënpar.1.5 i këtij Kodi parashkrimi i ndjekjes penale për këtë vepër është në afat prej 3 vitesh dhe rrjedhimisht pasi që kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me kompensimin e dëmit materiale e sipas LMD parashkrimi është 3 vite nga momenti që i dëmtuari e kupton për dëmin atëherë në këtë rast nuk zbatohet neni 358 i LMD pasi që afati i parashkrimi të veprës penale nuk është më i gjatë

se afati i parashkrimit të kompensimit të dëmit, element ky që kërkohet në nenin 358 të LMD-ës së vjetër. Po ashtu ka shtuar se padia e paditësit nuk është e bazuar në prova pasi që për këtë dëme asnjëherë nuk është bërë ndonjë ekspertizë nga eksperti i lëmisë përkatëse për ta vërtetuar këtë fakt kurse po ashtu marrjen e kësaj prove, paditësi deri në fund të seancës përgatitore nuk e ka propozuar. Andaj mbi këtë bazë i njejt i ka propozuar gjykatës që kërkesëpapia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Gjithashtu i njejt i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë, 100 € për një përfaqësim në një seancë.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova materiale: Aktgjykimi penal i plotëfuqishëm më datë 11.12.2013 me numër veprues P.nr.565/12; Transkasioni i konsumatorit DL4237, në emër të A.A i datës 28.07.2017.

Nga Aktgjykimi penal i plotëfuqishëm më datë 11.12.2013 me numër veprues P.nr.565/12, gjykata vërtetoi faktin se i padituri në bazë të këtij aktgjykimi është shpallur fajtor dhe është denuar me denim me gjobë në shumë prej 150,00€, i cili aktgjykim ka marrë formën e prerë më datën 11.12.2013.

Nga Transaksioni i konsumatorit DL4237, i datës 28.07.2017, gjykata vërtetoi faktin se ky transaksion edhe më tutje evidentohet në emër të A. A

Gjykata pas analizimit dhe shtjellimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, e refuzoi kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar ngase në bazë të provave të administruara gjykata nuk ka vërtetuar faktin se nga cila datë është shkaktuar dëmi material nga i padituri, poashtu në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që në rastin konkret nuk kemi ndonjë ekspertizë nga eksperti përkatës për të vërtetuar dëmin e shkaktuar nga i padituri, në rastin konkret kemi kërkesën e paditëses se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri më datën 02.02.2012, në shtëpinë e tij me qëllim që ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke keqpërdorur njehësorin elektrik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ku në këtë mënyrë ka pamundësuar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, andaj nga këto veprime e ka dëmtuar paditësin në vlerën e lartëcekur, andaj pasi që nuk kemi të vërtetuar dëmin, gjykata erdhi në përfundim se një kërkesë e tillë duhet të refuzohet.

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të të paditurit se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës, një pretendim i tillë nuk qëndron ngase neni 377 i LMD së vjetër që ka të bëjë me kërkesën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me vepër penale parasheh se *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*, andaj në rastin konkret pasi që kemi të bëjmë me veprën penale vjedhje nga neni 252 par.1 i Kodit të Përkohshëm Penal i Kosovës parasheh se *“Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet”*, duhet të kalojë dyfishi i kësaj vepre penale tri vite plus tri vite të tjera dhe në këtë rast dëmi është shkaktuar më datën 02.02.2012, ndërsa paditësja padinë e ka paraqitur më dt.02.07.2017 çka do të thotë se paditësja në afatin e paraparë ligjorë e ka paraqitur padinë.

Gjithashtu duke u bazuar në nenin 319 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ka paraparë që “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, kurse neni 322.1 ka paraparë “në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”, ndërsa neni 322.2 ka paraparë “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj poqese ligji nuk parasheh diq tjetër”, gjykata vendosi që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses t’ia refuzoj si të pabazuar, ku provat e administruara nuk kanë vërtetuar themelsinë e kërkesëpadisë, andaj mbi këto baza gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e obligojë paditësen që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,00.00€, edhe atë për përfaqësim të një seance gjyqësore duke u mbështetur në nenin 451.1 të LPK-ës.

Andaj, nga të cekurat më lart dhe në kuptim të nenit 143 pika 1 dhe nenit 450 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELOR NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.543/17, më datë 25 Janar 2021**

**Gjyqtarja,**  
Mirvete Alidemi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:104346  
Datë: 16.02.2021  
Numri i dokumentit: 01512636